

Ana Di LELLIO

Motivimi i luftës së Jasharajve përmes tregimit të ngjarjes

Për të filluar prezantimin, së pari, një rrëfimi i shkurtër: disa vjet më parë, isha në Prekaz. Ciceroni Rifat Bejta po fliste me vizitorë të huaj që nuk flisnin shqip dhe më kërkoi të përktheja, por shpejt e humbi durimin me mua. Ndoshta sepse shqipja ime nuk ishte emirë, apo unë isha shumë e ngadalshme. Nuk e di! Kështu që, zoti Bejta më tha: “Ju tregojeni historinë drejtpërdrejt në anglisht”. Ai e dinte mirë që unë shkova në Prekaz të paktën një herë në vit, që e kisha intervistuar atë dhe ciceronët e tjerë shumë herë, Xhevat Imerin për shembull, dhe që i kisha regjistruar prezantimet e tyre shumë herë.

Vërtet, unë e njoh Prekazin dhe Kosovën mirë, sepse kam kaluar tetëmbëdhjetë vitet e fundit duke punuar në Kosovë, duke gjurmuar politikën dhe kulturën e Kosovës, duke qenë e pranishme në shpalljen e Kosovës dhe pavarësisë së saj.

Në Kosovë unë kam më shumë miq sesa në Itali, aty ku edhe u linda, dhe në Nju Jork, ku tani unë jetoj dhe punoj si profesoreshë e politikës në Universitetin NYU. Këtu jam kumbare e vajzës pesëvjeçare e cila është më e njohur se unë në Facebook, Dalia Qena. Por, atë ditë në Prekaz, më e rëndësishmja për mua ishte që, zoti Bejta më besoi të tregoja historinë e Jasharajve siç duhet. Unë u ndjeva e nderuar nga kërkesa e tij.

Por këtu, sot, dua t’ju tregoj diçka tjetër. Sot, dua t’ju tregoj si kuptova dhe interpretova masakrën e Prekazit si një akademike amerikan e pavarur. Pse më interesonte historia e Jasharajve?

Masakra e familjes luftarake të Jasharajve, të vranë në fshatin Prekaz në luftë me trupat serbe, nuk ishte masakra e vetme apo më e madhe gjatë konfliktit të fundit. Gjatë vitit 1998, më shumë se treqind civilë shqiptarë u vranë nga forcat serbe. Në përgjithësi, mesmarsit dhe bombardimeve të NATO-s, u vranë rreth shtatëqind vetë, shumica civilë, dhe në fund të kësaj lufte u vranë më shumë se dhjetëmijë civilë dhe njëmijë luftëtarë të UÇK-së.

Të gjitha masakra janë “masakra të zakonshme” - kështu historianët i quajnë masakrat nga nazistët gjermanë gjatë Luftës së Dytë Botërore, sepse ishin të shpeshta dhe nuk kishin ndonjë shkak të qartë apo ishin pjesë e një strategjie të terrorizmit shtetëror -në Kosovë edhe të spastrimit etnik.

Por, pavarësisht këtyre numrave të mëdhenj, në kontekstin e kohës, Prekazi qëndron si një rast i jashtëzakonshëm. Pse?! Doja të dija pse dhe e kam hulumtuar dhe shkruar për këtë dy ese me kolegen Stephany Schwandner-Sievers.

Në fund kam arritur të kuptoj pse masakra e Prekazit është e jashtëzakonshme. Prekazi është vendi ku u ndërtuan shumë rrëfime. Interpretimi im është që: *e para*, rrëfimi i Jasharajve, të lindur dhe të rritur në rajonin kryengritës të Drenicës, nuk fillon në Prekaz në mars të vitit 1998. Jasharajt janë të fundit në vazhden e gjatë të heronjve lokalë. *Së dyti*, as vdekja dhe shkatërrimi i shtëpive të tyre nuk është përfundimi i rrëfimit: menjëherë pas asaj masakre lufta u intensifikua edhe filloi një fushatë në media, letërsi, art, historiografi dhe në ceremonitë publike për të prodhuar kuptimi dhe kujtime të masakrës si simbol i çlirimit kombëtar shqiptar.

Më interesonte shumë: që ky simbolizëm ka mbështetje të fortë në imagjinatën shqiptare në komunitetet në Kosovë, dhe në rajonin e

Ballkanit, dhe në mesin e diasporës; që Adem Jashari është i njohur si *komandant legjendar*; që vendi ku ai u vra me familjen e tij është vendi popullor për të vizituar; dhe vizitat kanë marrë karakter të pelegrinazhit.

Për studiuesit vendorë dhe ndërkombëtarë, fenomeni i Prekazit është shumë interesant për këtë arsye: 1) Ky është fenomen i cili ndihmon për studimin e nacionalizmit nga “një perspektivë ngjarjeje”, [eventfulness of nationalism] si e ka definuar sociologu shumë i njohur amerikan, Rogers Brubaker. Masakra e Prekazit na ofroi një mundësi unike për të kuptuar marrëdhënien midis kujtesës, historisë dhe kombit, ashtu siç përjetohet dhe negociohet. 2) Ky fenomen tregon rëndësinë e tregimit dhe traditës në mobilizimin e njerëzve për të luftuar. Këto dy çështje janë të lidhura. Jasharajt u vranë dhe, edhe pse ka pasur fëmijë në mes e tyre, nuk konsiderohen viktimë, por heronj që nuk pranojnë të dorëzohen. Ata janë konsideruar “dëshmorë të kombit” që nuk është e njëjta me *Shahitin* (martirin islamik të xhihadit). Ata janë dëshmorë në kuptimin burimor të “dëshmisë së kauzës”, që është e pranishme në teologjitë e krishtera dhe islame: ata dëshmojnë me martirizimin e vet se kombi ekziston. Komandanti legjendar është figurë mitike, sepse ai lidhë brezat e kaluar dhe të ardhshëm me kombin.

Figura e Adem Jasharit i kishte të gjitha elementet për t’u transformuar në legjendë. Manifestimi i Adem Jasharit si komandant legjendar filloi menjëherë pas ngjarjes, kur ai u shndërrua në thirrje për rekrutimin e UÇK-së në Kosovë dhe jashtë. Legjenda u ndërtua nga vetë luftëtarët. Në fillim, kishte një konfuzion lidhur me lajmin e masakrës. Duke kapitalizuar në këtë, pjesëtarët e UÇK-së, veçanërisht Rexhep Selimi, përhapën fjalë mbi ikjen dhe shpëtimin e Adem Jasharit. Ata krijuan imazhin e komandantit më të madh se jeta, dhe i

ndihmuan mitit të jetës pas vdekjes së heroit, duke e lidhur atë me luftëtarë shqiptarë në fillimin e shekullit XX, Azem Galicën, i cili besoj se ishte gjallë edhe pas vdekjes së tij aktuale.

Besarta, e vetmja vajzë e mbijetuar, ofroi dëshminë e vetme të këtyre ngjarjeve, të cilat shpejt u konsoliduan si rrëfim koherent heroizmi përball një armiku shumë më të fuqishëm. Ajo rrëfente se të gjithë Jasharajt morën pjesë në betejë, përderisa “axha Adem” këndonte këngë patriotike.

Rrëfimi mbi masakrën u shërbeu si material mësuesve dhe gazetarëve, të cilët brenda natës u bënë historian kombëtarë dhe pa humbur kohë artikuluan temat e mitit - qëndresa deri në vdekje, sakrificë për dashurinë ndaj atdheut, dhe pavdekësi - përmes një prodhimi të pasur të rrëfimeve gojore dhe letërsisë së shkruar. Nga lajmet e hershme të gazetës *Zëri*, Adem Jashari doli si “ndërtues i një epoke të re,” kurse masakra u bë “kthesa e madhe” që ndryshonte drejtimin e historisë nga shtypja në liri.

Adem Jashari identifikohet lehtë nga figurat e tjera heroike vendore. Ai është mishërim i imazhit të “patriotit të vërtetë shqiptar” në kundërshtim me “korrupsionin jugosllav” të qytetarëve përmes përfitimeve politike dhe financiare nga ana e shtetit. Në një mënyrë fare moderne, ai e kishte ndërtuar veten si figurë legjendare. Thuhet se stili i tij ishte ai i kryengritësit kundër osmanëve, Çerçiz Topullit. Nipi i komandantit, Bashkimi, rikujton se në mëngjes Adem Jashari këndonte këngë patriotike, një prej tyre nga filmi *Liri a vdekje*, një biografi filmike popullore mbi Topullin.

Dëshmi të tjera e kujtojnë atë si njeri që fliste shumë pak, apo kur fliste nganjëherë përdorte fjali teatrale, si në fjalimin mbajtur para shokëve të tij pas sulmit policor në Likoshan: “ju sot jeni plagosur që

ne të jemi nesër të lirë”. Nuk është e rëndësishme nëse këto janë fjalë të sakta, është e rëndësishme që njerëzit ta kujtojnë atë në këtë mënyrë.

Zhvillimi i legjendës së Adem Jasharit pas vdekjes shpalos fatin individual të heroit në kornizën e një leksikoni kulturor dhe politik të veriut të Shqipërisë dhe Kosovës, që rrezonin në veçanti me popullatën nga viset rurale. Tiparet rurale tradicionale janë të ndërthurura me vetëdije në një rrëfim thelbësor, në mënyrë që legjenda të tregohet dhe ritregohet në zhanrin vendor të këngëve folklorike epike. Ata këndojnë për vendin, Drenicën, “malet,” dhe karakteristikat tipike të heronjve luftëtarë shqiptarë: pushkën, çiftelinë, kullën dhe odën, ku pleqtë recitojnë epikën heroike të patriotëve kryengritës shqiptarë. Të gjitha këto tema, të cilat janë me bollëk në folklorin shqiptar, përbënin një përvojë jetësore për Jasharajt. Patriarku Shaban i dinte përmendësh vargjet prej *Lahutës së Malcisë*. Unë e mësova këtë nga Avni Spahiu, babai i të cilit ishte mësues, e solli këtë tekst në Drenicë në vitet e pesëdhjeta, kohë kur librat në shqip ishin ende ilegal; si shumë të tjerë në atë kohë, e mësoi përmendësh këtë poemë për ta recituar në odë.

Për studiuesit e nacionalizmit është e qartë se nuk ka asgjë unike në Kosovë në këtë konstruktiv të legjendës kombëtare. Për të mbështetur kërkesën e tyre për shtetësi, shumë grupe të tjera kanë krijuar lidhje mes ngjarjeve të vona historike me një të kaluar më të largët, por dhe më të veçantë.

Ashtu si miti themelues i betejës së Tel Hait dhe heroit legjendar Trumpeldor i viteve të njëzeta të Shoqërisë Hebraike të Palestinës dhe ashtu si rrethimi dhe beteja e Alamos në vitin 1836, në Teksas, me epin e vdekjes së Deivid Croket, historia e Prekazit dhe Adem Jasharit sjellë një rrëfimin shumë të fuqishëm dhe lidhje me kujtesën.

Murat Jashari, nipi i Adem Jasharit, interpreton gjatë një interviste me mua, në mënyrë shumë të qartë, përpjesëtimin mitik të rrëfimit të familjes së tij: “Çdo komb ka një shenjtor dhe një histori që është themeli që formon shoqërinë, bazën e saj. Rrëfimi i familjes sime është një hallkë e zinxhirit, një lëvizje historike. Historia është një zinxhir që i ka rrënjët tek lufta e shqiptarëve: Azem Galica, Shaban Polluzha dhe të tjerët. Shqiptarët kanë qenë përherë nën shtypjen e huaj, qoftë nga Turqia, Austria, Serbia dhe ka pasur shumë momente të luftës për liri: kjo është çështja shqiptare në Ballkan”.

Si studiuese e nacionalizmit, unë kuptova pse për një numër të madh shqiptarësh nga rajoni dhe jashtë tij, Prekazi është një altar dhe shenjtëria e komandantit është e përcaktuar, në kuptimin dhënë nga sociologu klasik, Emile Durkheim, nga fakti i thjeshtë se ky vend dhe njerëzit e tij dallohen nga e zakonshmja, profania.

Jasharajt nuk u pushkatuan, ata iu përgjigjën zjarrit me zjarr. Adem Jashari u bë simboli i parë i një lloji tjetër të shqiptarit, nga ai paqësor, që dominonte gjatë viteve nëntëdhjetë; ai shënoi një ndryshim të rëndësishëm në qëndrimet popullore, sepse, shqiptarët ndoqën shembullin e tij dhe u bashkuan me mijëra si vullnetarë në UÇK. Legjenda e Adem Jasharit paraqet kështu një kundërrëfim ndaj rrëfimit të viktimizimit.

Ka një tjetër rrëfim në legjendë të Jasharajve që mbetet pak e varrosur dhe që unë dua ta kujtoj këtu në fund të prezantimit im.

Duke hulumtuar historinë e Jasharajve, unë mësova edhe që gratë e familjes Jashari nuk kanë qenë viktima. Ato kanë qenë luftëtare. E mësova se Adilja, gruaja e komandantit, ishte e para që vdiq derisa po u sillte municion luftëtarëve. Mësova edhe - dhe me befasi të madhe - se ndërsa ajo dhe të tjetra gra jetojnë përgjithmonë në zemrat e familjes

dhe rrethit, shumë pak në shoqëri i kujtojnë ato: Adilen, apo edhe Zahiden, Feriden, Zarifen; vajzat: Hidajeten (18), Valdeten (14), Selveten (20), Lirien (14), Igballen (13) Afeten (17); dhe fëmijët: Fatimen (8), Blerinen (7). Të gjitha ato duhet të kenë më shumë peshë në përkujtimoret zyrtare që u kushtohen dëshmorëve të luftës me të gjitha gratë të cilat kanë luftuar në Kosovë. Një numër i caktuar igrave iu bashkua UÇK-së si luftëtare dhënë shumë të tjetra padyshim kanë luajtur një rol mbështetës në rezistencën e armatosur. Gratë shërbenin, si: postiere, ndihmëse, kuzhinierë dhe infermiere, detyra këto që nuk gëzojnë lavd pas përfundimit të luftës. Nëse Adilja dhe të tjerat do të ishin gjallë sot, besoj se do të mbështesin gratë e mbijetuara nga dhuna dhe tortura nga forcat serbe, sepse edhe ato gra meritojnë të kujtohen. Zoti Rifat Jashari, mbështeti instalacionin artistik “Mendoj për Ty”, dedikuar të mbijetuarave, dhe ai i ndihmoi shumë, sepse, i bëri ato të ndiheshin krenare.

Është fakt se rrëfimi i masakrës së Jasharajve sjellë një simbolizëm të fortë mbi një vuajtjeje të madhe, që prek të gjithë dhe që i bashkon ata në një bashkësi kombëtare. Shumica nga të anketuarit në Kosovë ma thanë se sakrifica e jashtëzakonshme e Jasharajve, që është e pamundur të shpaguehet në atë masë, i bën ata mirënjohës. Ata pohojnë se pa Jasharajt dhe vullnetin për të luftuar, Kosova ende do të ishte shoqëri e shtypur.

Mijëra familje shqiptare kanë përjetuar vdekje të dhunshme, burgosje dhe humbje të pasurisë private nga politika shtetërore serbe. Rrëfimi i Jasharajve, siç është ndërtuar, ka krijuar një lidhje të fuqishme midis këtij pësimi dhe shpëtimit prej tij.

